

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SARANDË SH.A
NJOFTIM ANULLIMI

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri	Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë SH.A
Adresa	Qafë-Gjashtë, Sarandë, Rruga “Skënderbeu”
Tel/Faks	085226264
E-mail	shauk.sarande@gmail.com
Ueb-faqe	www.shuk.al

2. Lloji i procedurës: E hapur

3. Numri i Referencës se procedures/lotit: REF 15949-08-12-2024

4. Objekti i Kontratës: “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësit të fshatit Çiflik dhe ndërtim pusi”

5. Fondi Limit: 37,892,769.17(tridhjetë e shtatëmilion tetëqind e nëntëdhjetë e dymijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

6. Arsyet e Anulimit:

- ☐ në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
- ☐ Xnë procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
- ☐ konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- ☐ për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
- ☐ kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në LPP;
- ☐ kur titullari i autoritetit kontraktor vendos anulimin sipas parashikimeve në nenin 19/4 të LPP.

7. Informacion shtesë

Autoriteti Kontraktor duke marrë shkasë nga komunikimi me Agjencinë e Prokurimit Publik si dhe pas verifikimeve të kryera pranë institucioneve përgjegjëse lidhur me kualifikimin e BOE “Cogren”shpk dhe “J O G I” shpk, konstatoi se Drejtuesi Teknik ne Licencën e kategorisë III.2.B, Z. Aleko Lango nuk rezulton i punësuar pranë shoqërisë “Cogren”shpk.

Kjo e vërtetuar dhe nga shkresa e Drejtorise Rajonale Tatimore Sarande nr. 844/1, datë 13.03.2025. Sipas ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për liçensim është Çertifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të. Fakti që drejtuesi Teknik nuk është i deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma “ a” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” , çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është pale.Per sa me larte procedura u ridergua per rivlersim

Duke qene se pas procedures se rivleresimit rezultoi se asnje opertator ekonomik nuk permbushte kushtet e kerkuara Autoriteti Vendosi Anullimin e Procedures se Prokurimit, bazuar ne nenin 98 pika b

Me publikimin e këtij formulari, nisin afatet e ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të Ligjit 162/2020 “Per prokurimin publik”, te ndryshuar.